



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË  
TIRANA PARKING  
DREJTORIA E PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Tiranë , më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT (PARAPRAK)**

[Data]: 17.09.2024

Drejtuar: **CLASS ASHENSOR Shpk** me adresë: Tiranë Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selite.

Procedura e prokurimit: **“E Hapur”**

Numri i referencës së procedurës: **REF-16217-08-14-2024**

**Loti 1: REF-16222-08-14-2024**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Shpenzime mirëmbajtje rrugë, vepra ujore, rrjet hidraulik, elektrik, telefonik, ngrohje etj (e ndare me lote)”**

**Loti 1 “Mirembajtje e ashensoreve”**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini Nr.51 datë 19 Gusht 2024

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. **“CLASS ASHENSOR” Shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L01325010Q**

*Numri i NIPT-t*

Vlera: **1 756 500** (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) **lekë pa Tvsh.**

2. **“HASIMAJ ELEVATOR CO” Shpk**

*Emri i plotë i shoqërisë*

**L11511001A**

*Numri i NIPT-t*

Vlera: **1 960 000** (një milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë) **lekë pa Tvsh.**

Nga pjesërmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

**1. “HASIMAJ ELEVATOR CO” Shpk**

**L11511001A**

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

*arsyet e mëposhtme;*

Operatori ekonomik “Hasimaj Elevator Co” ka paraqitur formularin e sigurimit të ofertës në formën e policës së sigurimit me nr. serie 14542, e lëshuar nga shoqëria siguruese ANSIG. Referuar përmbajtjes së policës së sigurimit rezulton se operatori ofertues ka depozituar pranë shoqërisë siguruese, shumën prej **39,200** (tridhjetë e nëntë mijë e dyqind) lekë, si kusht për sigurimin e ofertës dorëzuar nga operatori ekonomik.

Në pikën 3.1 të “Njoftimit të kontratës”, pjesë e dokumentave standarte të tenderit të publikuar në SPE është përcaktuar se për Lotin 1, me objekt “Mirëmbajtje ashensorësh”, vlera e sigurimit të ofertës e cila duhet të paraqitet nga ana e operatorëve ekonomik ofertues do të jetë **41,612.86** (*dyzet e një mijë e gjashtëqind e dymbëdhjetë pike tetëdhjetë e gjashtë*) lekë e cila përbën vlerën prej 2 % të fondit limit.

Nga krahasimi i vlerës së sigurimit të ofertës së paraqitur nga operatori “Hasimaj Elevator Co” në raport me vlerën e përcaktuar në “Njoftimin e kontratës”, rezulton vlera e siguruar nga operatori ofertues, e cila do të shërbej si garanci për përmbushjen e detyrimeve të marra përsipër nga ky operator gjatë kësaj faze, është me e vogël se vlera e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

Operatori ekonomik “Hasimaj Elevator Co” në përmbushje të pikës 2.2.2 të kapacitetit financiar ka paraqitur pasqyrat financiare për vitet 2021,2022,2023. Nga shyrtimi përmbajtjes së dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi, përkatësisht të pasqyrave financiare të viteve 2021,2022 dhe 2023, rezulton se keto pasqyra nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore, pasi nuk janë të shoqëruar me shkresën përcjellëse të Drejtorisë Rajonale Tatimore dhe nuk përmbajnë vulën zyrtare të kësaj drejtorie, por janë paraqitur vetëm me firmën e administratorit të shoqërisë dhe vulën e kësaj të fundit.

Si rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesi “Hasimaj Elevator Co” në përmbushje të pikës 2.2.2 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, nuk është në përputhje me përcaktimet e kësaj pike, për shkak se pasqyrat financiare të ngarkuara në SPE nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore.

Lidhur sa më sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofretave, vlerëson se ofertuesi “Hasimaj Elevator Co” nëpërmjet dokumentacionit të dorëzuar nuk përmbush kriteret kualifikuase të përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit, përkatësisht vlerën e sigurimit të ofertës e cila është me e vogël se

vlera prej 2% e fondit limit dhe pikën 2.2.2 të “kapacitetit ekonomik dhe financiar” për shkak se pasqyrat financiare të viteve 2021,2022 dhe 2023 të paraqitur nga ky operator nuk janë të konfirmuara nga organet tatimore.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **“CLASS ASHENSOR” Shpk** me adresë: Tiranë Njesia Administrative Nr.5, Rruga Hasan Vogli, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 68/68-d2, Selite, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1 756 500** (një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e pesëqind) **lekë pa Tvsh./** totali i pikëve të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si Oferta e suksesshme.  
Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”.

## **TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Erinda Fino**